



Komuna e Lipjanit

**Memorandum Bashkëpunimi  
në mes të  
Platforma CiviKos  
dhe  
Komuna e Lipjanit**

#### Lënda e bashkëpunimit

Platforma CiviKos përfaqësuar nga Drejtorja Ekzekutive znj. Donika Emini, si dhe Kryetari i Komunës të Lipjanit z. Imri Ahmeti janë pajtuar që në kuadër të aktivitetit Auditimi Social<sup>1</sup> zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation – Kosovo, të nënshkruanjë këtë memorandum bashkëpunimi.

Ky memorandum bashkëpunimi është lidhur me qëllim të zbatimit të këtij aktiviteti, respektivisht monitorimit të projektit kapital “Ndërtimi i Rezervuarit të Ujit dhe Rehabilitimi i Rrjetit të Ujësjellësit në Janjevë” nga Granti i Performancës Komunale, nga grupi i qytetarëve të Komunës së Lipjanit, sipas metodologjisë dhe parimeve të Auditimit Social.

#### Përgjegjësitet dhe aktivitetet e Platforma CiviKos

Platforma CiviKos në kuadër të aktivitetit Auditimi Social në Komunën e Lipjanit, do të përzgjedh një grup të qytetarëve të përbërë nga 15-20 qytetarë, të cilët në një mënyrë ose tjetër ndikohen nga projekti kapital që zbatohet nga Komuna. Përveç tyre, grupi mund të përbëhet edhe nga profesionistë të lëmive të ndryshme si inxhinier, arkitekt, psikolog etj., të cilët mund të kenë edhe njohuri profesionale dhe teknike varësisht natyrës që ka projektin.

Platforma CiviKos do të ofrojë një trajnim për ekipin e auditimit social, si dhe do të lehtësoj takimet me grupin e qytetarëve, si dhe në tërësi procesin e monitorimit të projektit nga këndvështrimi i tyre.

Grupi i qytetarëve të Auditimit Social në Komunën e Lipjanit do të mbajë disa takime të përbashkëta në mesin e tyre po ashtu edhe me përfaqësues të zyrës së Kryetarit të Komunës, si dhe drejtori të tjera relevante në kuadër të komunës. Ky grup po ashtu do të monitorojë projektin për nga afér përmes vizitave në teren. Të gjitha këto do t'i shërbejnë ekipit të qytetarëve që si përfundim të përpilojnë një raport me gjetje dhe rekomandime për projektin.

Raporti do të dërgohet dhe diskutohet me përfaqësues të komunës, për të analizuar nëse informatat janë në përputhje me situatën reale në të cilën gjendet projekt, si dhe për të evitar çfarëdo lloj keqkuptimi

---

<sup>1</sup> Aktivitet në kuadër të projektit për Decentralizim dhe Përkrahje të Komunave (DEMOS) i cili bashkëfinancohet nga Bashkimi Evropian në Kosovë, Zvicra, Suedia dhe Norvegjia, dhe implementohet nga HELVETAS Swiss Intercooperation-Kosovo





Komuna e Lipjanit

apo keqinterpretimi të mundshëm. Po ashtu ndarja e raportit me komunën do të shërbej për të plotësuar me informata shtesë nëse është e domosdoshme.

**Përgjegjësitet e Komunës të Lipjanit**

Komuna e Lipjanit të ofrojë hapësirë veprimi për grupin e qytetarëve të formuar në kuadër të Auditimit Social për të lehtësuar më tutje procesin e monitorimit të projektit, si dhe për të arritur deri tek përpilimi i gjetjeve dhe rekomandimeve gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në dëshmi. Këtë gjë Komuna e Lipjanit zotohet ta arrijë përmes ofrimit të qasjes për ekipin e qytetarëve në informata dhe dokumente të ndryshme rreth procesit të konsultimit, planifikimit, buxhetimit, zbatimit, apo monitorimit të projektit. Kjo gjë do arrihet duke u bazuar në legjislacionin aktual për qasjen në dokumente publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.

Përveç qasjes në informata, dhe dokumente publike, Komuna e Lipjanit do të mundësojë takime në mes të grupeve të qytetarëve dhe Kryetarit të Komunës, apo përfaqësuesve të drejtive relevante me qëllim të njohjimit për së afërm me projektin që monitorohet.

Për të arritur angazhim dhe detyrim të ndërsjellë përfundimtar ndaj procesit të auditimit social, Komuna e Lipjanit bie dakord që të përpilojë një plan të veprimit 3-6 muaj pas procesit të monitorimit, atëherë kur ekipi i qytetarëve ka përpiluar raportin e monitorimit dhe prezantuar gjetjet dhe rekomandimet e tyre. Kjo me qëllim për të siguruar përcjelljen dhe progresin e arritur në drejtim të adresimit të gjetjeve dhe rekomandimeve.

**Donika Emini**

Drejtore Ekzekutive, Platforma CiviKos

**Imri Ahmeti:**

Kryetar i Komunës së Lipjanit